


ÇFARË MIKSI I ENERGJISË NA DUHET?

Si ta mbjellim
Agjendën e Gjelbër
në Mretërinë
e Qymyrit?





ÇFARË MIKSI I ENERGJISË NA DUHET?

**Si ta mbjellim
Agjendën e Gjelbër
në Mretërinë
e Qymyrit?**

AUTOR:

Luan Shllaku

RIINVEST

Lidhja e Prizrenit nr. 56 Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320;
www.riinvestinstitute.org

Këndvështrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve. Instituti Riinvest merr përsipër përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e këtij raporti.

E DREJTA AUTORIALE © 2024 NGA INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruer apo tjetër, pa e cituar burimin.

Përmbajtja

Hyrje.....	7
Përmbledhje ekzekutive	11
Trilema e Energjetikës së Kosovës.....	13
Linjiti, ky armik i dashur!	18
Burimet e rinovueshme të energjisë	22
Gazi - një urë drejt një të ardhme më të pastër?	25
Rajoni një shansë dhe një bashkëpunim i munguar	32
Ku mbështetet siguria energjetike në strategjinë aktuale?	35
Një e ardhme energjetike e pasigurt - a do të mjaftojnë planet e dhëna në Strategji?	38
Rekomandime	40
Literatura:	42

**... të gjithë në
Kosovë e dinë 🌀
se çka po ndodh,
😊 por nuk ka
vendosmëri
për të marrë
hapa 💡 konkrete
për të lënë pas
qymyrin**



Hyrje

Kosova, e mbuluar me një histori të gjatë varësie nga linjiti, ndodhet në një udhëkryq kritik zhvillimorë. Motoja “ne flejmë mbi qymyr dhe duhet ta shfrytëzojmë këtë përparësi”, e rrënjosur thellë në mendësinë e shumë qytetarëve dhe vendim-marrësve, aktualisht e ka vënë vendin në një pozicion sfidues. Linjiti, i konsideruar si simbol i prosperitetit dhe fuqisë ekonomike, e ka mbështetur një kohë të gjatë zhvillimin e vendit. Megjithatë, kjo varësi e thellë ndeshet me detyrimet ndërkombëtare dhe me presionin e integritetit evropian, të cilat e kanë sjellë një paradigëmë të re - Axfordendën e Gjelbër, që kërkon një kalim drejt burimeve më të qëndrueshme të energjisë. Sot, Kosova përballet me një sfidë konkrete: si ta shmangim krizën e ardhshme energjetike dhe të integrohemi në një botë që po afrohet me shpejtësi drejt një të ardhme të qëndrueshme dhe të pastër?

Asnjë qeveri deri tash në Kosovë nuk e kanë sfiduar këtë mentalitet, duke e vështirësuar edhe më shumë tranzicionin e energjisë. Madje, edhe në kuadër të Axfordendës së Gjelbër, të cilën Kosova është e detyruar ta zbatojë nëse do të integrohet në Bashkimin Evropian, mungon më shumë kurajo të lihet pas linjiti dhe të planifikohet me më shumë vendosmëri tranzicioni energjetik me më shumë energji të rinovueshme.

Në fakt, sektorin e energjisë e karakterizon një dualitet i thellë. Nga njëra anë, linjiti mbetet karburanti i vetëm serioz për gjenerimin e energjisë elektrike, duke siguruar 91 % të nevojave aktuale të vendit. Nga ana tjetër, energjia e rinovueshme ka filluar të shfaqet në skenën energjetike Kosovare, si një shpresë për një të ardhme më të qëndrueshme. Megjithatë, ky tranzicion ndeshet me pengesa të mëdha. Këto dy pista zhvillimore mbesin me përkrahës të ndarë: vendim-marrësit deri tash favorizojnë linjitin, ndërsa disa ekspert dhe organizata civile promovojnë vazhdimisht një tranzicion më të shpejtë dhe më dinamik drejt burimeve të reja dhe të ripertërishme të energjisë (BRE).

Kjo situatë komplekse nxjerr në pah faktin se të gjithë në Kosovë e dinë se çka po ndodh, por nuk ka vendosmëri për të marrë hapa konkrete për të lënë pas qymyrin, i cili ka sjellë sfida mjedisore dhe shëndetësore të mëdha, duke përfshirë ndotjen e mjedisit dhe masat konkrete për të arritur neutralitetin e karbonit.

Thënë troq, janë katër karakteristika që e bëjnë mozaikun energjetik në Kosovë:

- 1** Dominimi i linjitet në prodhimin e energjisë elektrike në termocentralet Kosova A dhe Kosova B, që gjenerojnë më shumë se 90% të energjisë elektrike në vend ;
- 2** Një potencial i kufizuar i BRE (Burimeve të Ripërteritshme të Energjisë), që aktualisht është në rritje, por energjia e gjeneruar nga energjia solare, era dhe hidrocentralet, bën një pjesë shumë të vogël të bilancit perfundimtar energjetik;
- 3** termocentralet e stër-vjetruara Kosova A dhe B janë në decenien e gjashtë respektivisht në decenien e pestë të eksplotimit, që i bënë të jenë ndër TC-të më të vjetra në botë, dhe
- 4** Varësia nga qymyri ngrë shqetësime të konsiderueshme mjedisore, duke përfshirë ndotjen e ajrit dhe emetimet e gazrave serrë.

Kjo situatë na vënë para shumë sfidave, ku ma të shprehurat do të jenë:

- 1** Siguria e Energjisë që është e varur shumë nga importet e energjisë, duke e bërë vendin të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të çmimeve dhe ndërprerjeve të furnizimit;
- 2** Nevoja për ndërhyrje të menjëhershme mjedisore, shkaktuar nga varësia nga qymyri, që ka pasoja të rënda në mjedis dhe në shëndet publik, duke kontribuar në ndotjen e ajrit dhe ndryshimet klimatike;
- 3** Stresi Financiar i krijuar nga mirëmbajtja dhe përmirësimi i njësive të vjetra prodhuese, shkakton një presion të madh në financat publike, duke kufizuar investimet në zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe
- 4** Integrimi në BE sjell obligimin që t'i përmbahemi përcaktimit global për vendosje të neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050 që faktikisht e vendos një trysni mbi Kosovën për të ndërprerë varësinë nga qymyri dhe për të përkrahur burime të pastra energjie.

Objektivi i kësaj analize është të sjell informacion relevant për gjendjen aktuale në energjetikë, duke u bazuar në raportet zyrtare të punës së sektorit të energjisë si dhe në Planin Nacional të Energjisë dhe Klimës 2025-2030, i cili e projekton zhvillim e ardhshëm të këtij sektori deri në vitin 2040, dhe t'i shqyrtojë në mënyrë kritike skenaret zhvillimore të paraqitur, për t'iu gjetur përgjigjet më të përafërta këtyre pyetjeve:

- A mund të arrijë Kosova aspiratat e saj të integritit evropian, duke përmbushur njëkohësisht qëllimet ambicioze të Marrëveshjes së Gjelbër, veçanërisht në lidhje me varësinë nga linjiti? Cili është kompromisi që mund të bëhet midis rritjes ekonomike, sigurisë energjitike dhe qëndrueshmërisë mjedisore?
- Cili është Miksi Energjetik optimal për Kosovën, duke marrë parasysh kufizimet që i sjell linjiti dhe modelet zhvillimore të bazuara në Agjendën e Gjelber të BE? Kjo analizë vlerëson potencialin e BRE, veçanërisht energjise solare, eres dhe ujit, për të zëvendësuar linjtin si burim kryesor i energjisë.
- Si mund të arrijë Kosova nevojat e saj energjitike afatshkurtëra, duke e krijuar njëkohësisht themelin për një sistem energjetik të qëndrueshëm dhe afatgjatë? Kjo përfshin marrjen në konsideratë të gjendjes aktuale të sektorit energjetik, infrastrukturës ekzistuese dhe potencialit për investime të reja në teknologjitë e energjisë së rinovueshme.

Kosovës i duhet një moto e re për t'iu zëvendësuar ato të vjetrat, që mund të definohet si *"më pak linjit, më shumë Europë"*:

Mbështetja dominante e Kosovës në resurse fosile – linjit, paraqet sfida të konsiderueshme mjedisore dhe ekonomike. Qëllimet ambicioze të Marrëveshjes së Gjelbër, së bashku me nevojën për anëtarësim në BE, na e krijojnë një argument bindës për kalimin në një të ardhme më të pastër energjitike. Por ky kalim kërkon një shqyrtim të kujdesshëm të specifikave të Kosovës, veçanërisht rezervave të mëdha të linjtit dhe varësinë e saj nga termocentralet elektrike me qymyr, të cilat ka kohë që e kanë kaluar afatin e tyre të punës normale!

Për t'u përgjigjur sfidave aktuale globale, Kosova ka nevojë për një Miks të Energjisë të bërë me kujdes, që merr parasysh këto premisa:

- Kalimi gradual nga linjiti në resurse tjera energjetike, do të jetë jetik, duke kërkuar një qasje të balancuar që merr në konsideratë edhe infrastrukturën ekzistuese, ndikimin ekonomik dhe zhvillimin e mundësive alternative të gjenerimit të energjisë.
- Shfrytëzimi i potencialit të diellit, erës dhe energjisë hidrike është i rëndësishëm për të zëvendësuar linjitin. Megjithatë, burimet e pakta ujore të Kosovës paraqesin kufizime të rëndësishme në potencialin për zhvillimin e energjisë hidrike.
- Optimizimi i konsumit të energjisë përmes masave të përmirësuara të efikasitetit dhe të menaxhimit të kërkesës mund të zvogëlojë nevojën për kapacitete të reja të prodhimit të energjisë dhe të sigurojë një sistem energjetik më të qëndrueshëm.

Përmbledhje ekzekutive

Kosova ndodhet në një kryqëzim të rëndësishëm zhvillimor. Një histori e gjatë e varësisë nga linjiti, i cili gjeneron mbi 91% të energjisë elektrike, përballet me premtimin e një të ardhme Europiane, e cila i sjellë detyrimet karshi Axhendës së Gjelbër. Mendësia e decenieve të fundit se “ne jetojmë në Mbretërinë e Qymyrit” e ka krijuar një dilemë të vështirë: si ta balancojmë nevojën për zhvillim ekonomik me përgjegjësinë për mjedisin dhe të ardhmen e qëndrueshme?

Ky dokument, analizon sfidat dhe mundësitë me të cilat përballet Kosova në rrugën e saj drejt një të ardhme të pastër energjetike. Është eksploruar një miks energjetik i mundshëm, që do të siguronte energji të mjaftueshme për zhvillimin e vendit duke qëndruar brenda linjave të projektuara të Agjendës së Gjelbër dhe duke sjellë në vëmendje rëndësinë e diversifikimit të burimeve të energjisë dhe zhvillimit të një strategjie energjetike më të guximshme!

Analiza e kryer zbulon se Kosova po përballet me një sfidë monumentale: planifikimi i ardhshëm i saj energjetik nuk merr parasysh plotësisht realitetin e rritjes së kërkesës për energji elektrike, kufizimet e resurseve të rinovueshme në vend, dhe sfidat e tranzicionit energjetik që është i bazuar në prodhimin e energjisë elektrike nga linjiti. Strategjia Kombëtare e Energjisë 2022-2031 synon të rrisë energjinë e rinovueshme dhe të përmirësojë efikasitetin energjetik, por kjo nuk është e mjaftueshme për të garantuar një të ardhme të qëndrueshme dhe të sigurt.

Analiza tregon se Kosova do të përballet me një deficit të energjisë prej cca 2,500 GWh deri në vitin 2040, edhe pasi të ketë zbatuar planet e saj aktuale. Kjo do të thotë se Kosova do të duhet të mbështetet në importe të energjisë, duke rritur varësinë nga furnizuesit e jashtëm dhe duke e bërë vendin më të ndjeshëm ndaj çmimeve të luhatshme dhe ndërprerjeve të mundshme. Në mënyrë më të përgjegjshme, Kosova duhet të shqyrtojë me urgjencë opsione alternative, duke e përfshirë:

Kosova ndodhet në një kryqëzim të rëndësishëm zhvillimor. Një histori e gjatë e varësisë nga linjiti, i cili gjeneron mbi

91%

**TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

● **Importi i Gazit Lengezuar Natyror te (LNG)**, si një burim më i pastër i energjisë se sa linjiti, mund të luajë një rol të rëndësishëm gjat tranzicionit të energjisë drejt vitit 2050 kur emisioni i gazërave serë duhet të shkojë në zero. Importin e LNG nga Greqia ose lidhja me tubacionin Adriatik në Shqipëri janë opsione që duhet të shqyrtohen me seriozitet, duke marrë parasysh kostot, përfitimet dhe sfidat e mundshme.

● **Gazifikimin e linjtit në Obiliq**, që do ta sjellte përsëri përvojën e dy dekadave që Kosova ka me gazin sintetik (sin-gazin) në të kaluarën. Kjo strategji, e kombinuar me teknologji moderne të kapjes së karbonit, mund të ofrojë një alternativë më të qëndrueshme për përdorimin e linjtit.

● **Investimet në Burimet Ujore të Shqipërisë:** Shqipëria ka një potencial të madh të hidroenergjisë që mund të shfrytëzohet për të gjeneruar energji të pastër për të dy vendet. Deri tash, të gjitha kartat e bashkëpunimit kanë shkuar në drejtim të këmbimit të energjisë, por asnjëherë nuk është shqyrtuar seriozisht mundësia e gjenerimit të energjisë bazuar në hidro-potencialin e Shqipërisë. Kjo kërkon bashkëpunim rajonal më të ngushtë.

● **Përballë kufizimeve të resurseve ujore të Kosovës**, është e domosdoshme që Kosova të zhvillojë një strategji të qëndrueshme për menaxhimin e ujit. Ky plan duhet të përfshijë investime në infrastrukturën e ujit, përmirësimin e efikasitetit të përdorimit të ujit dhe reduktimin e ndotjes së ujit, duke shmangur ndërtimin e hidrocentraleve në zonat e mbrojtura.

Në mënyrë që të shmangët një krizë energjetike në të ardhmen, Kosova duhet të veprojë me shpejtësi dhe vendosmëri. Një plan i qartë energjetik që do të përfshijë një gamë të gjerë zgjidhjesh, duke marrë parasysh rëndësinë e investimeve të vazhdueshme në energjinë e rinovueshme, eksplorimin e burimeve alternative të energjisë, përmirësimin e efikasitetit energjetik, dhe promovimin e bashkëpunimit rajonal është thelbësor për të siguruar një të ardhme energjetike të qëndrueshme dhe të përbalueshme për Kosovën.

Trilema e Energjetikës së Kosovës

Kosova ndodhet në një udhëkryq, e kapur midis tre sfidave kryesore që përcaktojnë të ardhmen e saj energjitike.

E para, vendi mburret me rezerva të mëdha të linjtit, të mjaftueshme për të furnizuar centralet e energjisë elektrike për dekada të tëra. Shprehja “ne flejmë mbi qymyr”, e rrënjosur thellë në mentalitetin e shumë qytetarëve dhe vendim-marrësve, i ka dhënë vendit një perceptim të fuqisë ekonomike dhe të bollëkut energjetik.

E dyta, Kosova është e përkushtuar thellësisht për t’u integruar në Bashkimin Evropian, një rrugë që kërkon harmonizimin e strategjisë së saj energjitike me objektivat ambicioze të Marrëveshjes së Gjelbër. Ky angazhim kërkon një kalim të qartë nga linjiti kah burimet e pastra të energjisë, duke sjellë në skenë një sfidë të madhe: si ta menaxhojmë varësinë nga linjiti dhe t’i përmbushim detyrimet tona mjedisore?

Dhe e treta - për të qenë gjithçka më komplekse - Kosova përballet me një mungesë të theksuar të resurseve ujore, duke e bërë atë një nga vendet më të varfëra në Evropë në këtë drejtim.

Kjo trilemë unike - rezervat e mëdha të linjtit, përkushtimi për një të ardhme pa linjit dhe mungesa e burimeve ujore - krijon një sfidë të rëndësishme që e vështirëson dukshëm zhvillimin e ardhshëm të energjetikës në vend. Si mund të harmonizohen interesat ekonomike me aspiratat mjedisore dhe dëshirën për integrimin Evropian? Cili Miks i Energjisë mund të plotësojë me të vërtetë nevojat e ardhshme energjitike, duke e balancuar potencialin e energjisë së rinovueshme me nevojën për një kalim të shpejt në një epokë të re pa linjitin si karburant energjetik?

Kjo analizë synon të navigojë në këtë peizazh kompleks, duke eksploruar zgjidhje të mundshme dhe në fund të fundit, duke kërkuar t’i përgjigjet kësaj pyetjeje të rëndësishme: A mund të ndërtojë Kosova një të ardhme energjitike të qëndrueshme që balancon rritjen ekonomike, përgjegjësinë mjedisore dhe integrimin evropian?

Kosova ndodhet e mbërthyer në një konfrontim të vështirë midis një mendjësie të të jetuarit në “Mbretërinë e Qymyrit”, dhe premtimit të një të ardhme të pastër sipas Axhendës së Gjelbër të BE-së.



Të jetosh në “Mbretërinë e Qymyrit”

Kosova ndodhet e mbërthyer në një konfrontim të vështirë midis një mendjwsie të të jetuarit në “Mbretërinë e Qymyrit”, dhe premtimit të një të ardhme të pastër sipas Axfordës së Gjelbër të BE-së. Rezervat e mëdha të linjtit kanë krijuar një perceptim të pasurisë kombëtare, duke lidhur qymyrin me prosperitetin, krenarinë kombëtare dhe stabilitetin politik. Kjo lidhje e ngushtë, e përforcuar nga një ndjenjë e thellë krenarie kombëtare për këtë pasuri, ka formuar diskursin politik dhe opinionin publik. Megjithatë, kjo lidhje po bëhet gjithnjë e më pak e rëndësishme përballë angazhimit të BE-së për neutralitet të karbonit dhe fokusit të saj në energji të pastër. Vizioni i BE-së për eliminimin e karburanteve fosile krijon një konflikt të rëndësishëm me varësinë tradicionale të Kosovës nga linjiti, duke paraqitur një sfidë të madhe për Kosovën në rrugën e saj drejt integritimit në BE.

Kur politikat zhvillimore bazohen në paradigmat e shekullit të kaluar

Kosova përballet me një sfidë të madhe në tranzicionin nga linjiti në burime alternative të energjisë. Vendim-marrësit politikë, të mbuluar nga një mentalitet thellësisht të rrënjësor në mendësinë “ne flejmë mbi qymyr,” e shohin linjitin si një burim të sigurt energjie, duke e vështirësuar kalimin në një të ardhme të qëndrueshme. Ky perceptim, i përforcuar nga frika e humbjes së vendeve të punës dhe destabilizimit ekonomik, e ka mbuluar nevojën për të shqyrtuar me seriozitet burimet alternative të energjisë.

Për dekada, Kosova është parë si një “fuqi rajonale energjetike” për shkak të rezervave të saj të mëdha të linjtit. Kjo “Mbretëri e Qymyrit” e ka formuar pejsazhin ekonomik dhe politik të vendit, duke e vendosur në qendër të vëmendjes shfrytëzimin e këtij resursi, dhe duke e lënë të pa-diskutuar nevojën për të diversifikuar burimet tona të energjisë. Në këtë kontekst, ndikimi mjedisor i qymyrit mbetet i neglizhuar, me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve dhe mjedisin.

Ky mentalitet, i përforcuar nga udhëheqësit politikë që mendojnë se të sfidosh përdorimin e linjtit do të shkaktojë reagim të fortë nga votuesit të cilët e shohin atë si simbol të prosperitetit dhe krenarisë kombëtare, e ka ngadalësuar ndryshimin e nevojshëm. Për më tepër, industria e qymyrit në Kosovë punëson një numër të konsiderueshëm njerëzish dhe gjeneron një pjesë të konsiderueshme të prodhimit ekonomik të vendit. Kjo e ka bërë të vështirë të sfidohet status quo-ja, duke krijuar një dinamikë ku vlerësohen vetëm shqetësimet ekonomike në disfavor të atyre mjedisore dhe qëndrueshmërisë afatgjate.

Për të naviguar me sukses në këtë pejsazh politik, Kosova ka nevojë për vendim-marrje kurajoze dhe të fortë politike, komunikim efektiv dhe strategji gjithëpërfshirëse që i adreson shqetësimet e të gjithë palëve të interesuara. Një vizion i qartë për një të ardhme të qëndrueshme të energjisë, një angazhim për investime afatgjata dhe një dialog i hapur me qytetarët, bizneset dhe udhëheqësit e industrisë janë thelbësore për të ndërtuar një konsensus rreth një të ardhme që i përcjell trendet zhvillimore të kohës.

Strategjia e Energjisë së Kosovës 2022-2031 - një dokument i pakryer


Ndonëse Kosova përballet me një krizë të thellë energjetike, Strategjia e re e Energjisë për periudhën 2022-2031 nuk ofron një plan të qartë dhe të përshtatshëm për të adresuar sfidat aktuale. Përkundrazi, strategjia sjell disa mangësi të rëndësishme që ngrenë shqetësime për efektivitetin e saj.

Strategjia nuk është në përputhje me Strategjinë e mëparshme, duke krijuar një ndjenjë të përsëritjes së panevojshme, pa futur elemente të reja që i adresojnë sfidat aktuale. Për më tepër, ajo paraqet një kontradiksion të qartë duke propozuar rikonstruktimin e termocentraleve të vjetra, Kosova A dhe Kosova B, pavarësisht nga synimet për dekarbonizim. Një investim i tillë në teknologji të vjetruar që kërkon më shumë qymyr për të prodhuar të njëjtën sasi energjie që shpenzojnë sot termocentralet e kohës është një hap prapa në përpjekjet për të arritur dekarbonizimin dhe sigurinë energjetike.

Strategjia e re gjithashtu nuk i adreson në mënyrë adekuate çështjet e lidhura me energjinë e rinovueshme dhe bashkëpunimin rajonal. Ajo nuk jep mjaft garanci për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik, duke i përfshirë këto aspekte vetëm në mënyrë marginale.

Përfundimisht, strategjisë së re të energjisë i mungon vizioni dhe guximi i nevojshëm për të prezantuar projekte afatgjata dhe me kosto të lartë, të cilat janë thelbësore për të adresuar krizën aktuale të energjisë dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme të energjisë për Kosovën.





Ky mentalitet, i përforcuar nga udhëheqësit politikë që mendojnë se të sfidosh përdorimin e linjtit do të shkaktojë reagim të fortë nga votuesit të cilët e shohin atë si simbol të prosperitetit dhe krenarisë kombëtare, e ka ngadalësuar ndryshimin e nevojshëm.

Linjiti, ky armik i dashur!

Kosova mburret me rezervat më të mëdha të lignitit në Europë, të vlerësuara në 14 miliardë ton. Ky burim ka qenë gurthemeli i sistemit të saj të gjenerimit të energjisë për dekada, duke siguruar një burim karburanti të lirë dhe lehtë të disponueshëm. Megjithatë, varësia e vazhdueshme nga linjiti përballet me sfida të konsiderueshme. Ai paraqet një shqetësim të trefishtë, duke e penguar rrugën e Kosovës drejt një të ardhme të qëndrueshme të energjisë:

- **RREZIQE PËR SHËNDETIN PUBLIK:** Përdorimi i linjitit për gjenerimin e energjisë paraqet rreziqe të konsiderueshme për shëndetin, veçanërisht për shkak të afërsisë së termocentraleve Kosova A dhe Kosova B me Prishtinën dhe rrëthinën e saj. Në këtë zonë, në diametër prej 30 kilometrash nga tyntarët e termocentraleve jeton një popullsi prej rreth 300,000-400,000 banorësh. Djegia e linjitit emiton sasi të konsiderueshme të gazrave serrë, si dhe ndotësve primar të ajrit, duke përfshirë dioksidin e karbonit, dioksidin e sulfurit, oksidet e azotit dhe pluhurin. Këta ndotës kontribuojnë në sëmundjet e sistemit respirator, problemet kardiovaskulare dhe probleme të tjera shëndetësore, veçanërisht te popullatat e ndjeshme. Për më tepër, minierat sipërfaqësore për dekada me radhë, së bashku me mirëmbajtjen e pamjaftueshme të deponive të hirit që gjenden vetëm 3-4 km larg Prishtinës, paraqesin një rrezik permanent. Këto depozita, që zënë mijëra hektarë, përmbajnë një sasi të konsiderueshme të hirit nga djegia e linjitit, dhe sa herë që era fryn drejt Prishtinës një sasi e madhe e pluhurit respiratorik arrin në Prishtinë dhe zonat e banuara përreth, duke e rezikuar dukshëm jetën e banorëve të saj.
- **INFRASTRUKTURA E VJETRUAR:** Përdorimi i lignitit në Kosovë komplikohet më tej nga fakti që dy termocentralet, Kosova A dhe Kosova B, janë shumë të vjetra. Këto termocentralet janë ndërtuar shumë dekada më parë dhe nuk kanë teknologji adekuate për të minimizuar emetimet e gazërave serrë dhe ndotësve të ajrit dhe ujit. Termocentralet, edhe përkundër intervenimeve të kohëpaskohëshme, kanë ngelur me standarde të ulëta për zbutjen e problemeve mjedisore, duke kontribuar në ndotjen e ajrit dhe duke ngitur rreziqet ndaj shëndetit të popullatës përreth.

- **BURIMI ANAKRONIK:** Varësia e vazhdueshme nga linjiti është një strategji anakronike, në kontekstin e Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së dhe aspiratave të Kosovës për integrim European. Marrëveshja e Gjelbër vendos objektiva ambicioze për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë, dhe kërkon me këmbëngulje ndërprerjen e përdorimit të karburantëve fosil, duke përfshirë edhe linjitin. Kosova, si një anëtare e ardhshme e BE-së, do të duhej të harmonizojë politikat e saj energjetike me rregulloret e BE-së dhe potencialisht të përballet me sanksione nëse nuk i përmbush objektivat e Marrëveshjes.

Plani Nacional për Energji dhe Klimë 2025-2030 (PNEK) e njeh nevojën për të zvogëluar emetimet e gazrave serrë (GHG), duke synuar një reduktim prej 16.3% në krahasim me nivelet e vitit 2016 deri në vitin 2030. Ky objektivi është vendosur nga Komuniteti i Energjisë, ku Kosova është anëtare. PNEK e sjell këtë skenar për ta arritur këtë reduktim: Zvoglimi i 36% të emetimeve të GHG deri në vitin 2030 në krahasim me nivelet e vitit 2016, duhet të bëhet kryesisht përmes masave të efikasitetit energjetik dhe disa zgjerimeve të energjisë së rinovueshme.

Largimi nga përdorimi i linjtit

Pika më neuralgjike e Strategjisë së Kosovës është mungesa e një plani strategjik që e largon Kosovën nga përdorimi i linjtit. Kosova duhet të zhvillojë një plan të tillë, duke u bazuar në:

- **MBYLLJEN GRADUALE E TERMOCENTRALEVE:** Vendosja e një afati kohor për mbylljen e termocentraleve Kosova A dhe Kosova B, duke siguruar një kalim të qetë në burime alternative të energjisë.
- **INVESTIMET NË ENERGINË E RINOVUESHME:** Prioritizimi i investimeve në energji diellore, energji e erës dhe hidroenergji, së bashku me masat e efikasitetit energjetik, për të zëvendësuar prodhimin e energjisë bazuar në linjit.
- **BASHKËPUNIMIN RAJONAL:** Angazhimi me vendet fqinje, posaçërisht me Shqipërinë për të zhvilluar projekte të përbashkëta për gjenerimin e energjisë së rinovueshme dhe tregtinë ndërkufitare,
- **BURIMET FINANCIARE:** Sigurimi i financimit nga BE-ja dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë për të mbështetur tranzicionin kah burimet e ripërtëritshme dhe projektet rajonale
- **REHABILITIMIN E DËMEVE MJEDISORE:** Zhvillimi i një plani për menaxhimin mjedisor të depozitave ekzistuese të hirit, si dhe sipërfaqeve të ndotura përreth termocentraleve ekzistuese duke përfshirë masa të mundshme për minimizimin e ndikimit negativ në shëndetin e popullatës që jeton përreth.

Emetimet e gazerave te serës nga sektori i energjisë

Sektori i energjisë është përgjegjës për shumicën dërmuese të emetimeve të gazrave serrë në Kosovë. Rreth 86% e totalit të emetimeve, ose 8.7 milion ton CO₂ eq. vijnë nga ky sektor. Shkaku kryesor është djegia e lënjës, për prodhimin e energjisë elektrike.

Industria e energjisë është kontribuuesi më i madh, duke gjeneruar 73% të emetimeve të sektorit të energjisë, ose 6,3 milion ton CO₂ eq. Pas saj vjen transporti me 15% të emetimeve, industria e prodhimit dhe ndërtimit me 7%, dhe sektorët e tjerë të energjisë me 5%.

Emetimet nga mihjet e linjës janë të kufizuara, por ende prezantojnë një shqetësim. Në të kundërtën, ruajtja dhe transporti i dioksidit të karbonit nuk janë relevante në këtë moment për Kosovën. Ndër gazrat e emetuara, dioksidi i karbonit (CO₂) është dominues me 99.95% të totalit, ndërsa metani përbën vetëm 0.5%.

Edhe pse Kosova ka emetime më të ulëta të CO₂ për frymë (5 ton CO₂ ekuivalent) se sa mesatarja e Bashkimit Evropian, ajo ka emetime më të larta se disa vende të rajonit. Shqetësues është fakti se emetimet e CO₂ për njësi të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) janë shumë të larta në Kosovë, me 0.5 kg CO₂ për njësi. Kjo është më e lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian dhe më e lartë se sa të gjitha vendet e rajonit, përveç Bosnje dhe Hercegovinës.

Industria e energjisë është kontribuuesi më i madh, duke gjeneruar

73%

të emetimeve të sektorit të energjisë, ose
6,3 milion ton CO₂ eq.



Kufizimet e ujit

Kosova, ndryshe nga shumë vende të tjera në Ballkan, ka një problem të madh me ujin. Resurset e ujit janë shumë të kufizuara, duke e vështirësuar zhvillimin e hidroenergjisë, e cila është një burim i rëndësishëm i energjisë së rinovueshme. Vetëm 10% e ujërave që rrjedhin në Kosovë janë nga burime të jashtme, ndërsa pjesa tjetër janë ndërkufitare. Kjo e bën menaxhimin e ujit edhe më kompleks dhe e ekspozon Kosovën ndaj presionit të madh nga ndryshimet klimatike, të cilat pritet të reduktojnë disponueshmërinë e ujit për 20% deri në vitin 2046-2065. Shikoni këto fakte:

- Të reshurat vjetore për banor në Kosovë janë 4,107 m³, krahasuar me 10,705 m³ në rajon.
- Kosova ka një kapacitet të instaluar të hidroenergjisë prej 108.24 MW, por kjo është shumë e vogël në krahasim me potencialin e vendeve të tjera të Ballkanit.
- Në vitin 2019, prodhimi i HEC-ve përbënte vetëm rreth 10% të gjithë prodhimit të energjisë në Kosovë.
- Lumi Drini i Bardhë, Lumi i Ibrit, Lumi i Moravës së Binçës dhe Lumi i Lepencës, që përbëjnë burimet kryesore të ujit në Kosovë, kanë një potencial të vlerësuar të hidroenergjisë prej rreth 700 GWh/vit. Megjithatë, shumica e këtyre potencialit ndodhet në zona të mbrojtura, duke e vështirësuar zhvillimin e HEC-ve në këto vende.

Burimet e rinovueshme të energjisë

Plani i qeverisë për të rritur pjesëmarrjen e burimeve të energjisë së rinovueshme në miks të përfundimtar të energjisë është ambicioz, duke synuar arritjen e 43 % të energjisë së rinovueshme në konsumin e energjisë finale deri në vitin 2030 duke parashikuar një zgjerim të konsiderueshëm të energjisë diellore, erës, hidrike dhe të biomasës. Të ndara sipas burimeve, ky plan parashikon që deri në vitin 2030, energjia e erës do të dominojë prodhimin e energjisë elektrike të rinovueshme, duke kontribuar me 25% e ndjekur nga energjia diellore fotovoltaike me 13% dhe energjia hidrike me 5%. Teprica, deri në 7 TWh, sa parashihet të jetë konsumi total në 2030, do të gjenerohet nga TC-të me linjit (57%). Poashtu plani parashikon një kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 1,400 MW, nga energjia diellore fotovoltaike (730 MW) dhe era (670 MW) deri në vitin 2030.

Megjithatë, realizimi i këtij vizioni është i mbushur me sfida, veçanërisht duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të Kosovës. Ekziston një keqkuptim i zakonshëm se instalimi i një kapaciteti të caktuar të energjisë diellore ose të erës do të përkthehet drejtpërdrejt në të njëjtën sasi të prodhimit të energjisë. Në realitet, prodhimi efektiv i paneleve diellore dhe turbinave të erës është dukshëm më i ulët për shkak të faktorëve si kushtet e motit, ndërprerjet dhe kufizimet e ruajtjes së energjisë. Zakonisht, instalimet diellore dhe të erës gjenerojnë vetëm 15-30% të kapacitetit të tyre të instaluar. Kjo do të thotë që kapaciteti i planifikuar prej 1,400 MW nga energjia diellore dhe era mund të gjenerojë vetëm 300-350 MW të energjisë. Kjo është dukshëm më pak se prodhimi i tanishëm i gjeneruar nga impiantet Kosova A dhe Kosova B, të cilat, sot, së bashku kanë në dispozicion një fuçi prej më shumë se 900 MW.

Kosova ndryshe nga shumë vende të tjera në Ballkan, e ka një problem të madh, të cekur më heret: ka kufizim të ndjeshëm të mundësive për të zhvilluar hidroenergjinë, e cila do të ishte një burim i rëndësishëm i energjisë së rinovueshme. Derisa projektet e vogla të energjisë hidrike mund të ndërtohen, projektet e mëdha të hidrocentraleve me më shumë se 100 MW fuçi nuk gjejnë rrjedh ujore për tu ndërtuar.

Për shkak të kësaj, Kosova do të duhet të mbështetet kryesisht në burimet e tjera të energjisë, siç janë energjia diellore dhe energjia e erës. Për të përmbushur qëllimet e energjisë së rinovueshme, bashkëpunimi rajonal me vendet fqinje, siç është Shqipëria, e cila ka një potencial të madh ujor, është thelbësor. Studimet e kryera

nga Qeveria e Kosovës në vitet 2006, 2009 dhe 2010 tregojnë se zona e Pejës dhe Junikut ka potencialin më të madh për hidroenergji, por ndodhet në zona të mbrojtura të natyres. Kjo shfaq qartë se Kosova përballlet me një dilemë të vështirë: shfrytëzimi i plotë i burimeve të ujit që i posedon do të rrezikojë mjedisin dhe biodiversitetin e zonave të mbrojtura. Prandaj, edhe pse Kosova mund të mos jetë e aftë të mbështetet në hidroenergji si një burim i rëndësishëm i energjisë së rinovueshme, është e rëndësishme të krijohet një plan strategjik për menaxhimin e ujit. Kjo përfshin ruajtjen e burimeve të ujit, investimet në infrastrukturë, dhe zhvillimin e teknologjive të reja për shfrytëzimin më të mirë të burimeve të kufizuara të ujit.


Kosova është një nga vendet më të stresuara nga uji në Evropën Juglindore për shkak të karakteristikave specifike natyrore të kombinuara me presionin njerëzor: mungesë investimesh në infrastrukturën e ujit, përdorim joefikas i ujit dhe ndotja e ujit nga minierat, ujërat e papërpunuar të kanalizimeve, si dhe rrjedhjet e ujit nga bujqësia. Kërkesa në rritje për ujë e përkeqëson sfidën. Modifikimet e rrjedhave dhe strukturave të lumenjve dhe pellgut rrisin rrezikun e thatësirave dhe përmytjeve. Ndërhyrja e ndryshimeve klimatike rrit ndjeshmërinë e ekosistemeve dhe ekonomisë. Karakteri ndërkuftar i katër pellgjeve të lumenjve komplikon më tej menaxhimin e ujit. Megjithëse Politika Kombëtare e Ujit promovon një qasje të IWRM (Integrated Water Resources Management - Menaxhimi i Integruar i Burimeve të Ujit) dhe Ligji Për Ujërat prezanton praktika bashkëkohore të menaxhimit të ujit me bazë në BE, një kornizë funksionuese e IWRM nuk është ende e vendosur në Kosovë.

Kosova me një sipërfaqe prej rreth 10,000 kilometra katrorë, dhe me popullsi të dendur, me më pak se 200 banorë për kilometër katror, e ka të kufizuar dukshëm sipërfaqen e tokës së përshtatshme për instalime të një shkalle të gjerë të energjisë diellore dhe të erës. Për më tepër, Kosova ka një klimë kontinentale me ditë të kufizuara diellore dhe potencial relativisht të moderuar të erës.

Gjithashtu, është e rëndësishme të dijmë se të gjitha të dhënat e prezentuara zyrtarisht deri tash për energjinë e rinovueshme në Kosovë mbështeten edhe në përdorimin e biomasës, veçanërisht drurit. Ndërsa druri i cili përdoret aktualisht për ngrohje, është një karburant ndotës që e përkeqëson më tej cilësinë e mjedisit. Nësëe Kosova do të ndryshojë qëndrim dhe do të përdor më pak dru për ngrohje, ajo do të përballlet me sfida të mëdha në arritjen e objektivit të saj prej 32% të energjisë së rinovueshme. PNEK vlerëson që deri në vitin 2030, kapaciteti i instaluar i burimeve të energjisë së rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike do të jetë rreth 59% i kapacitetit të përgjithshëm të instaluar, me kontribute të konsiderueshme nga era dhe energjia diellore. Megjithatë, kapaciteti aktual i instaluar i burimeve të energjisë së rinovueshme në Kosovë është dukshëm më i ulët se ky kapacitet i projektuar, i ardhshëm. Si përfundim, adoptimi i gjerë i energjisë së rinovueshme në Kosovë përballlet me disa pengesa: burime të kufizuara ujore - mungesa e ujit në vend kufizon rëndë potencialin për zhvillimin e energjisë hidrike, që e sjell një pengesë kryesore për një transformim të qëndrueshëm energjetik. Faktorët rëndësues janë: (1) sipërfaqja e vogël e Kosovës dhe popullsia e dendur që e kufizojnë

disponueshmërinë e tokës së përshtatshme për instalime të shkallës së gjerë të energjisë diellore dhe të erës; (2) klima kontinentale e vendit, me ditë të kufizuara diellore dhe potencial të moderuar të erës; (3) varësia e tanishme nga druri për ngrohje, një karburant ndotës, që poashtu varfëron fondin drunor, ngre shqetësime në lidhje me qëndrueshmërinë dhe ndikimin mjedisor. Kapaciteti i planifikuar për erën dhe energjinë diellore, edhe pse ambicioz nuk është i mjaftueshëm për të zëvendësuar prodhimin e energjisë nga centralet elektrike me qymyr, duke e bërë eliminimin e këtyre centraleve elektrike të vjetruara një detyrë shumë të vështirë.

Zgjidhja e këtyre sfidave kërkon një qasje strategjike dhe shumëdimensionale. Investimi në burime të qëndrueshme të biomasës, të tilla si mbetjet bujqësore, është thelbësor për të zbutur ndikimin mjedisor të përdorimit të biomasës. Poashtu duhet gjetur zgjidhje inovative: Kosova duhet të zgjerojë dukshëm potencialin e energjisë së rinovueshme, duke i konsideruar edhe sistemet për ruajtjen e energjisë. Nuk duhet lënë anash as mbështetja e politikave nxitëse të investimeve në energjinë e rinovueshme, që në rend të parë thjeshton dukshëm proceset e marrjes së lejeve për investim dhe promovon ngritjen e eficiencës së energjisë. Edhe pse vizioni për një të ardhme të energjisë së rinovueshme në Kosovë është ambicioz, realiteti në terren paraqet pengesa të rëndësishme.



Zakonisht, instalimet diellore dhe të erës gjenerojnë vetëm

15-30%

të kapacitetit të tyre të instaluar. Kjo do të thotë që kapaciteti i planifikuar prej 1,400 MW nga energjia diellore dhe era mund të gjenerojë vetëm 300-350 MW të energjisë.

Gazi - një urë drejt një të ardhme më të pastër?

Strategjia e parafundit, e energjisë në Kosovë 2019-2027 e cila u zëvendësua nga Strategjia 2022-2031 para se t'i skadojë koha, e planifikon gazin si një karburant strategjik dhe si pjesë e Miksit të Energjisë, për periudhën e ardhshme afatmesme. Aq më shumë, Parlamenti i Kosovës e solli Ligjin për Gazin Natyror, qysh në vitin 2016. Por, Strategjia ekzistuese 2022-2031 nuk llogaritet në përdorim të gazit në periudhën e ardhshme dhe nuk e bënë pjesë të Miksit që synohet në tri dekadat e ardhshme. Kjo Strategji, planifikon të kalojë në një të ardhme më të pastër të energjisë, me fokus në vazhdimin e përdorimit të termocentraleve ekzistuese me linjit në disa dekada të ardhshme si dhe në burimet e energjisë së rinovueshme përcjellur me ngritje të efikasitetit energjetik. Megjithatë, ky kalim do të kërkojë planifikim të kujdesshëm dhe investime të konsiderueshme, veçanërisht duke pasur parasysh kufizimet e vendosjes së energjisë së rinovueshme në Kosovë.

Realiteti është që një zëvendësim i plotë i linjtit në të ardhmen e afërt është i pamundur. Termocentralet Kosova A dhe Kosova B aktualisht prodhojnë rreth 5 TWh energji elektrike në vit, duke mbuluar një pjesë të konsiderueshme të konsumit të energjisë në vend. Strategjia planifikon që vendi duhet të vazhdojë të mbështetet në termocentralet me linjit, pa e caktuar kohën se kurr do të mbylleshin ato. Derisa Kosova përpiqet të integrohet në Bashkimin Evropian, do të ketë presion në rritje nga ana e saj për ta dekarbonizuar sektorin e energjisë.

Zëvendësimi i gjenerimit aktual të energjisë bazuar në linjit me burime të rinovueshme do të kërkojë investime të konsiderueshme dhe një zhvillim të shpejtë të infrastrukturës përcjellëse. Për të arritur qëllimet e përcaktuara në Deklaratën e Sofjes, Kosova duhet të heqë plotësisht centralet e energjisë me linjit deri në vitin 2050, me një objektiv të kuartë: të arrihet 55% e konsumit të energjisë së rinovueshme deri në vitin 2035. Edhe nëse e supozojmë një kalim më gradual, me qëllim të zëvendësimit të 3.5 TWh energji elektrike që aktualisht gjenerohen në termocentrale, me energji diellore dhe me erë deri në vitin 2040, Kosova do të duhet të instalojë rreth 3,000 MW fuqi nga BRE-të për të përmbushur këtë kërkesë. Planet aktuale të qeverisë, siç përcaktohen në PNEK, nuk janë të tilla dhe nuk projektohet një investim i tillë që shkakton një hendek potencial midis ambicieve dhe realitetit.

Për të komplikuar më tej situatën, Kosova aktualisht importon rreth 20% të energjisë elektrike. Nëse duam ta arrijmë pavarësinë energjetike, pasi të jemi të obliguar të heqim dorë nga linjiti, do të duhet të rrisim ndjeshëm kapacitetin e prodhimit të energjisë elektrike në vend. Duke pasur parasysh potencialin shumë të kufizuar për hidroenergji dhe një perspektive jo aq shpresdhënëse për instalimin e BRE vendi do të duhet të shqyrtojë burime tjera të prodhimit të energjisë elektrike.

Shqyrtimi i Gazit si Zgjidhje Potenciale:

Në këtë kontekst, importi i gazit, si gazi i lëngshëm i naftës (LPG) ashtu edhe gazi sintetik i prodhuar përmes gazifikimit të linjtit, mund të jenë një zgjidhje potenciale e rëndësishme për të mbuluar hendekun që do të krijohet pasi që Kosova do të detyrohet t'i ndal termocentralet aktuale.

Tregu global i gazit ndodhet në një gjendje fluksi, i nxitur nga lufta në Ukrainë dhe kriza e energjisë që rezulton prej saj. Bota aktualisht ka rreth 7,000 miliardë metra kub rezerva të provuara të gazit, të mjaftueshme për të mbuluar nivelin e konsumit aktual për 53 vjet. Tregu global i gazit vlerësohet në 182 miliardë dollarë në vitin 2022, duke theksuar rëndësinë e këtij burimi të energjisë në miksin global të energjisë. Megjithatë, lufta në Ukrainë ka shqetësuar lidhjet tradicionale të furnizimit të energjisë, veçanërisht të gazit Rus, i cili është një burim kryesor i furnizimi për Evropën. Kjo ka çuar në rritje të çmimeve të gazit dhe e ka gjeneruar në anën tjetër një garë globale për burime alternative. Ndërsa gazi natyror konsiderohet përgjithësisht si një alternativë më e pastër se qymyret, ai ende kontribuon në emetimet e gazrave serrë, dhe roli i tij afatgjatë në një të ardhme të qëndrueshme të energjisë është duke u debatuar. Në këtë kontekst, Kosova, një vend pa akses në infrastrukturën rajonale të gazit natyror dhe me një varësi të madhe nga linjiti, përballet me një sfidë komplekse në përcaktimin e të ardhmes së saj energjetike. Përvoja historike e Kosovës, si vend që në vitet e 1970-89 ka prodhuar gaz duke e gazifikuar linjitin, dhe prodhuar të ashtuaquajturin gaz sintetik mund të ofrojë një zgjidhje të mundshme, por kërkon shqyrtim të kujdesshëm të ndikimeve mjedisore dhe disponueshmërisë së teknologjive të kapjes së karbonit.

Potenciali i investimit në gaz

Ndërsa gazi natyror digjet më pastër se karburantet e bazuara në naftë dhe qymyr, duke emituar ndjeshëm më pak dioksid karboni (CO₂), oksid azoti (NO_x) dhe dioksid sulfuri (SO₂), ai ende emiton dioksid karboni. Për të minimizuar ndikimin në klimë, do të duhet të zbatohen teknologji të kapjes dhe ruajtjes së karbonit. Termocentralet e energjisë me gaz mund të zëvendësojnë lehtësisht energjinë e prodhuar aktualisht nga termocentralet bazuar në linjit, duke siguruar një kalim relativisht të shpe-

jtë në një burim energjie më pak ndotës. Infrastruktura ekzistuese e Gazifikimit në Obiliq dhe gazsjellësit mund të shfrytëzohet pjesërisht për të gjeneruar gaz sintetik, duke zvogëluar nevojën për ndërtime të reja të konsiderueshme.

Në anën tjetër, gazi (LPG) mund të importohet nga Greqia përmes tubacioneve dhe porteve detare ekzistuese si ajo në Aleksandropulos, duke siguruar një zinxhir furnizimi relativisht të drejtpërdrejtë. Një analizë e kostove dhe përfitimeve sugjeron që përdorimi i gazit natyror mund të ofrojë kursime të konsiderueshme të kostove për klientët në krahasim me karburantet e bazuara në naftë dhe energjinë elektrike, veçanërisht pasi kostoja e energjisë elektrike nga termocentralet ekzistuese me linjit do të rritet dukshëm pasi të aplikohen sistemet e taksimit të BE të njohura si ETS dhe CBAM, por edhe për shkak të rekonstruksioneve të vazhdueshme që do të duhet bërë në termocentralet e stër-vjetruara. Kalimi nga përdorimi i linjitet duke djegur në termocentralet, në gaz natyror për qëllime industriale dhe komerciale mund të zvogëlojë ndjeshëm kërkesën e energjisë elektrike, duke zvogëluar nevojën për gjenerim të mëtejshëm të energjisë dhe duke zvogëluar varësinë nga importet e energjisë elektrike. Gazi natyror duhet të përdoret gjithashtu për ngrohje të hapësirës, ngrohje të ujit dhe gatim, duke zëvendësuar pajisjet joefikase dhe ndotëse të djegies së qymyrit ose druve në shtëpitë dhe sektorët industrial. Kjo do të zvogëlojë varësinë nga energjia elektrike për ngrohje dhe do të zvogëlojë emetimet.

Futja e gazit, si pjesë e një Miksi të Energjisë në Kosovë, është sa sfiduese aq edhe mundësi e mirë që ngrit shpresën për të gjetur një zgjidhje afatgjatë për shumë dekada të ardhshme.

Sfidat, mundësitë dhe opsionet e mundshme

Potenciali i gazit ka një domethënie në transferimin kah burimet energjetike të qëndrueshme dhe doemos kërkon një shqyrtim të detajuar dhe të kujdesshëm. Ai mund të ofrojë një zgjidhje të përkohëshme për të zëvendësuar linjitet? Megjithatë, është thelbësore të njohim sfidat mjedisore dhe ekonomike që lidhen me gazin dhe të zhvillojnë një plan që i adreson këto shqetësime. Një studim i menjëhershëm i fizibilitetit në këtë drejtim do të ishte përcaktues për të gjetur këtë përgjigje.

Përdorimi i gazit si pjesë e Miksit Energjetik paraqet si sfida ashtu edhe mundësi: (1) Ndërtimi i një rrjeti të gazpërçuesit që në Kosovë do të kërkojë investime të konsiderueshme dhe mund të zgjasë disa vite për ta përfunduar; (2) Kostot e importit të LPG ose zhvillimit të një impianti për prodhimin e gazit sintetik duhet të peshohen kundrejt përfitimeve të mundshme ekonomike të kalimit në një sistem energjie të bazuar në gaz; (3) Duhet të shqyrtohen me kujdes ndikimet mjedisore të përdorimit të gazit, duke përfshirë emetimet e mundshme të gazrave serrë, dhe të zbatohet strategji e përshtatshme për zbutjen e ndotjes, edhe pse ndotja e shkaktuar është shumë më e vogël se ajo që vjen nga djegja e qymyrit në termocentralet.

Importi i LPG nga Greqia:

LPG mund të importohet nga Greqia përmes tubacioneve dhe porteve detare ekzistuese, duke siguruar një zinxhir furnizimi relativisht të drejtpërdrejtë. Ky opsion do të kërkonte krijimin e një rrjeti të bartjes së gazit në Kosovë dhe shpërndarjes së tij.

Lidhja me TAP në Shqipëri:

Projekti i Tubacionit të Gazit Shqipëri-Kosovë (ALKOGAP) synon të lidhi sistemin ekzistues dhe të planifikuar të transmetimit të gazit të Republikës së Shqipërisë (duke përfshirë edhe projektin TAP) me sistemin e projektuar të transmetimit të gazit të Republikës së Kosovës, si dhe me lidhësit e transmetimit që janë pjesë e degës lindore të Rrethit të Gazit të Komunitetit të Energjisë (ECGR). Ky projekt synon të krijojë një rrugë të re furnizimi me gaz natyror nga Lindja e Mesme dhe rajoni i Kaspikut, i transportuar me Tubacionin Trans-Adriatik, në drejtim veriperëndimor të zonës së Ballkanit Perëndimor drejt Serbisë. Projekti ALKOGAP do të planifikohet si një tubacion dy-drejtimesh, kështu që drejtimi i mundshëm i furnizimit mund të jetë edhe nga veriu në jug, nga ECGR, ose nga burime të tjera.

Ndërtimi i këtij tubacioni do të mundësonte gazifikimin e Shqipërisë dhe Kosovës dhe do të siguronte një furnizim me gaz natyror të diversifikuar dhe të besueshëm. Ky projekt i furnizimit me gaz, me një gjatësi totale prej rreth 260 km, do të krijonte kushtet paraprake për zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve të gazit natyror të Shqipërisë, dhe krijimin dhe zhvillimin e tregjeve të gazit natyror të Kosovës në nivelin vjetor të vlerësuar prej 1.5 - 2 bcm (1-1.3 bcm për Shqipërinë dhe 0.5 - 0.7 bcm për Kosovën). Do të ishte e mundur të rritet kapaciteti i tij (të dyfishohet ose të trefishohet), në rast se ALKOGAP do të përdoret për të furnizuar Serbinë dhe vendet e tjera me gaz nga Kaspiku ose Lindja e Mesme. Kjo lidhje transmetimi, përveç përfitimeve për tregun evropian, do të jepte gjithashtu një nxitës të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik për vendet që kalohen.

Gazifikimi i Linjtit:

Kosova ka një histori të prodhimit të gazit sintetik nga ligniti, duke operuar një impiant të tillë midis viteve 1970 dhe 1989. Ky impiant, ishte pjesë e zingjirit energjettiko-kimik, njihej si "Gazifikimi", dhe ndodhej në Obiliq. Teknologjia e përdorur në atë kohë ishte "Lurgi", një proces i gazifikimit të qymyrit i dizenuar në Gjermani.

Ky impiant përdorte një proces kompleks për të prodhuar gazin sintetik. Linjiti digjej në temperaturë të lartë për të krijuar gazin sintetik, i cili pastaj përdorej si lëndë djegëse për industrinë nga Shkupi e deri në Trepçë-Mitrovicë.

Për të shqyrtuar saktësisht mundësinë e riaktivizimit të këtij impianti, duhet të merren parasysh sfidat e shumta që paraqiten. Për shembull, teknologjitë e kapjes së karbonit nuk ishin aq të zhvilluara në vitet 70-ta dhe 80-ta. Ky impiant nuk sillte probleme mjedisore lokale, por shikuar sot, dioksidi i karbonit është bërë “anmiku më i madh” i globit, për shkak të nxitjes së ndryshimeve klimatike. Për të shmangur ndotjen, është thelbësore të sigurohen investime të konsiderueshme në teknologjitë moderne të kapjes dhe ruajtjes së karbonit, si dhe të përdoren standarde më efikase mjedisore për prodhimin e gazit sintetik. Përveç kësaj, gjendja e infrastrukturës ekzistuese duhet të shqyrtohet me kujdes, duke përfshirë tubacionet, pajisjet dhe sistemet e kontrollit. Një vlerësim teknik i detajuar do të jetë i nevojshëm për të përcaktuar gjendjen e tyre aktuale dhe për të identifikuar investimet e nevojshme për t'i sjellë ato në përputhje me standardet moderne.

Pavarësisht nga përvoja historike e Kosovës me gazifikimin e linjitit, rinovimi i këtij impianti kërkon analiza të thella, vlerësime të kujdesshme dhe investime të konsiderueshme për të siguruar që është një zgjidhje e qëndrueshme dhe e mirë për mjedisin.

**Duke pasur parasysh
potencialin shumë të kufizuar për
hidroenergji dhe një perspektive jo
aq shpresdhënëse për instalimin e
BRE vendi do të duhet të shqyrtojë
burime tjera të prodhimit të
energjisë elektrike.**



Kosova ka një histori të prodhimit të gazit sintetik nga ligniti, duke operuar një impiant të tillë midis viteve 1970 dhe 1989. Ky impiant, ishte pjesë e zingjirit energjetiko-kimik, njihej si “Gazifikimi”, dhe ndodhej në Obiliq. Teknologjia e përdorur në atë kohë ishte “Lurgi”, një proces i gazifikimit të qymyrit i dizenuar në Gjermani.



Gazifikimi në Obiliq

Kosova ka një infrastrukturë të zhvilluar nëntokësore të gazsjellësit të gazit sintetik ose gjeneratorik, i cili fitohet duke e gazifikuar linjtin. Kjo infrastrukturë, pjesë e atëhere Kombinatit Xehtarë Energjetiko Kimik (KXEK), përfaqëson një aset të vlefshëm dhe një përvojë të gjatë në shfrytëzimin e gazit të prodhuar.

Gazsjellësi nëntokësor, me një gjatësi prej rreth 240 km, shtrihet nga Obiliq në drejtime të ndryshme, duke përfshirë Fushë Kosovë-Prishtinë-Ferizaj-Kaçanik-Hani i Elezit-Shkup, Obiliq - TC Kosova B-Vushtrri-Mitrovicë-Zveçan dhe Obiliq-Drenas. Ai furnizonte konsumatorët ekonomik, kryesisht në industri dhe në ngrohje qendrore.

Pavarësisht nga gjendja e keqe e infrastrukturës ekzistuese, traseja e gazsjellësit është shumë e saktë, dhe ky aset mund të shfrytëzohet për të ndërtuar një sistem të ri të furnizimit me gaz natyror. Përvoja 18-vjeçare e shfrytëzimit të gazit gjeneratorik, kryesisht në industri, është një argument shtesë për të konsideruar riaktivizimin e gazifikimit.

Në të kaluarën, Reparti i Gazifikimit të linjtit, kishte kapacitete për prodhimin e gazit gjeneratorik prej 90,000 m³/h gaz të papërpunuar (60,000 m³/h gaz të pastër nga 5 gjeneratorë të tipit Lurgy). Për këtë prodhimtari, ishin të nevojshme 80 tonë/orë linjit i terur, 9,900 m³ oksigjen me pastërti 96%, 65 tonë/orë avull i nxehtë teknologjik dhe rreth 28 MW energji elektrike.

Nga procesi i gazifikimit të linjtit janë prodhuar edhe produkte të tjera siç janë vaji i mesëm, katrani, fenoli, uji amonjaku, benzina e lehtë etj.

Kosova duhet të shqyrtojë me kujdes mundësinë e riaktivizimit të gazifikimit, duke marrë parasysh teknologjitë e reja të kapjes së karbonit për të minimizuar ndikimin mjedisor. Kjo do të kërkojë një vlerësim të detajuar të gjendjes aktuale të infrastrukturës, dhe investimet e nevojshme për modernizimin e saj.

Rajoni një shansë dhe një bashkëpunim i munguar

Ballkani Perëndimor ndodhet në një situatë komplekse ku përpjekjet e dekarbonizimit janë të pakta dhe jo efektive. Ndonëse rajoni është angazhuar për t'iu bashkuar axhendës së gjelbër të BE-së dhe për të arritur neutralitetin e karbonit deri në vitin 2050, rezultatet e deritanishme janë shqetësuese. Politika dhe mekanizmat e BE-së për mbështetjen e tranzicionit energjetik, sidomos në arritjen e objektivave të dekarbonizimit deri në vitet 2030 dhe 2050, nuk po sjellin rezultatet e pritura.

Ekspertët e energjisë në rajon besojnë se pa ndryshime të rëndësishme në politikat dhe mekanizmat e mbështetjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor, dekarbonizimi i rajonit do të mbetet një përpjekje e pamjaftueshme, ku vendet japin vetëm premtime boshe në lidhje me dekarbonizimin në politikat e tyre.

Analiza e fundit e bërë gjat vitit 2023, vlerësoi efektivitetin e politikave aktuale të qeverive të Ballkanit karshi energjisë dhe klimës, sipas standarteve të BE, në këtë rajon dhe i identifikoi sfidat dhe pengesat më të mëdha në dekarbonizimin e sektorëve të energjisë në vendet respektive. Përfundimet ishin alarmante dhe këto janë disa nga shkaqet:

- **NUK KA KONSULTIM TË GJERË PUBLIK** apo angazhim në procesin e tranzicionit të energjisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, për shkak të një qasje nga lart poshtë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Kjo mungesë e pronësisë demokratike dobëson qëndrueshmërinë dhe shpejtësinë e tranzicionit.
- **NDIKIMI I KUFIZUAR I CBAM** - Mekanizmi i Rregullimit Kufitar të Karbonit brenda BE-së (CBAM) nuk pritet të përshpejtojë në mënyrë të konsiderueshme dekarbonizimin e sektorëve të energjisë në Ballkanin Perëndimor. Ai mund të mos inkurajojë as futjen e mekanizmave të vendosjes së çmimeve të karbonit në rajon, pavarësisht nga deklaratat e tanishme të qeverive.
- **MUNGESA E KAPACITETIT FINANCIAR DHE TEKNIK** - Ndonëse qeveritë i shohin kompanitë publike të energjisë si aktorët kryesorë në tranzicionin e energjisë, këto kompani nuk e kanë kapacitetin e nevojshëm financiar dhe teknik për ta udhëhequr zhvillimin e energjisë së rinovueshme. Roli i aktorëve të tjerë kyç, siç janë investitorët privat, qeveritë lokale, SME-të dhe qytetarët, në lehtësimin e një tranzicioni të qëndrueshëm të energjisë është kryesisht i neglizhuar.

- **HENDEKU I TRANZICIONIT TË DREJTË** - Ndonëse BE-ja thekson konceptin e një tranzicioni të drejtë, duke ofruar ndihmë të konsiderueshme teknike dhe financiare për rajonet e qymyrit, Ballkani Perëndimor ka qenë i ngadaltë në përqafimin e këtyre programeve. Kjo lidhet kryesisht me mungesën e kushteve paraprake themelore për një tranzicion të drejtë, përfshirë vendimet obliguese në lidhje me afatet kohore për ndalimin e përdorimit të qymyrit dhe strategjitë gjithëpërfshirëse për mbështetjen e rajoneve që varen nga qymyri.
- **PENGESA FINANCIARE** - Tranzicioni i energjisë në Ballkanin Perëndimor, rajonin më të varfër ekonomikisht në Europë, nuk do të jetë i mundur pa mbështetje financiare të konsiderueshme nga BE-ja dhe vendet e tjera të zhvilluara. Varësia aktuale nga buxhetet shtetërore dhe konsumatorët lokalë të energjisë për të financuar tranzicionin është jorealiste, veçanërisht duke pasur parasysh burimet e kufizuara të rajonit.

Pra, derisa Ballkani Perëndimor i është përkushtuar një të ardhme të pastër, zbatim i këtij qëllimi përmes veprimeve konkrete mbetet i vështirë. Nuk ka planifikim specifik për të hequr dorë nga qymyri, dhe ka mungesë të ndjeshme të investimeve dhe mbështetjes nga ana e BE-së. Për të shmangur një dekarbonizim të çrregullt dhe të jo-efikas, duhet të merren masa të qarta dhe të shpejta për të ndryshuar strategjitë e reformimit të sektorit të energjisë në rajon.

Ballkani Perëndimor akoma larg marrëveshjes së Sofjes

Ballkani Perëndimor, është një rajon që mbështetet kryesisht në burimet e energjisë fosile, veçanërisht qymyrit. Shqipëria aktualisht ka një kapacitet të instaluar të hidroenergjisë prej rreth 2,600 MW, duke e bërë atë një prodhues të madh të energjisë së rinovueshme në rajon. Kosova, megjithatë, është dominuar nga linjiti, i cili përbën mbi 95% të prodhimit të energjisë së saj. Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina janë gjithashtu të varura nga qymyri, duke e bërë këtë rajon një nga më të ndoturit në Evropë.

Në vitin 2020, përdorimi i qymyrit në Ballkanin Perëndimor arriti në 48% të Miksit të Energjisë, ndërsa energjia e rinovueshme arriti vetëm në 22%. Kjo tregon qartë se rajoni ende ka një varësi të madhe nga qymyri dhe se përpjekjet për të kaluar në burime të pastra të energjisë po zhvillohen me shpejtësi të vogël.

Një studim i vitit 2023 konstaton se dekarbonizimi i sektorëve të energjisë në Ballkanin Perëndimor është i çrregullt dhe i "rremë". Ekziston një konflikt i madh midis premtimeve të politikës për një të ardhme të pastër dhe realitetit të varësisë së vazhdueshme nga qymyri. Kjo vështirësi e madhe në kalimin nga qymyri shpjegohet me faktorë të shumëfishtë, siç janë mungesa e konsultimit publik, ndikimi i kufizuar i mekanizmave të BE-së për dekarbonizim, dhe mungesa e kapaciteteve financiare dhe teknike në shumicën e vendeve të rajonit. Në këtë kontekst, marrëveshjet e arritura në Sofje për një tranzicion energjetik të qëndrueshëm në rajon, duke përfshirë dhe Deklaratën e Sofjes, duken se janë mbetur vetëm premtime pa veprime konkrete.



Tranzicioni i energjisë në Ballkanin Perëndimor, rajonin më të varfër ekonomikisht në Europë, nuk do të jetë i mundur pa mbështetje financiare të konsiderueshme nga BE-ja dhe vendet e tjera të zhvilluara.

Ku mbështetet siguria energjetike në strategjinë aktuale?

Kosova përballet me sfida të rëndësishme në sigurimin e energjisë, kryesisht për shkak të varësisë së saj nga dy centrale të vjetruara të energjisë me linjit, Kosova A dhe Kosova B. Këto centrale nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për të përmbushur kërkesën e brendshme, veçanërisht gjatë dimrit, dhe për të përmbushur kërkesat e kapacitetit rezervë të sistemit energjetik.

Qeveria e Kosovës e ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2022-2031. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është dekarbonizimi i plotë i sektorit të energjisë, duke u mbështetur në burimet e rinovueshme të energjisë (BRE), kryesisht energjinë e erës dhe diellore, si dhe në efikasitetin energjetik, duke synuar të rrisë pjesëmarrjen e burimeve të rinovueshme të energjisë në konsumin e energjisë elektrike në 35% deri në vitin 2031, nga 6.3% që ishte në vitin 2021.

Për të siguruar furnizimin me energji, strategjia parashikon investime në kapacitetet ekzistuese të gjenerimit të energjisë me bazë linjitet. Dy njësitë e Termocentralit Kosova B, thuhet në strategji, do t'i nënshtrohen një riparimi të madh, duke mundësuar funksionimin e tyre me parametra optimale teknike, si në sigurimin e kapacitetit të tyre gjenerues, ashtu edhe në avansimin e paisjeve për të përmbushur normat e emetimeve të parashtruara në standardet mjedisore Europiane.

Strategjia gjithashtu parashikon 170 MW (340 MWh) kapacitet të baterive për ruajtjen e energjisë. Kjo do ta lehtësojë integrimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe do të sigurojë përmbushjen e kërkesave të ENTSO-E për rezervat e energjisë.

Tashmë Kosova e ka një marrëveshje me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) për shkëmbimin e energjisë sipas nevojës. Megjithatë, Kosova ende varet nga importet e energjisë elektrike, veçanërisht gjatë sezonit të ngrohjes, kur kërkesa për energji elektrike është e lartë.

Çfarë Miksi i Energjisë na duhet?

Për të zvogëluar varësinë nga importet, kjo Strategji synon të rrisë efikasitetin energjetik dhe të investojë në kapacitetet ekzistuese të gjenerimit të energjisë me bazë linjtin për tu përgatitur për sfidat e viteve kritike kur pritet që Kosova t'i takojë kërkesat e komunitetit të energjisë dhe t'i përmbush të gjitha obligimet e marrura me nënshkrimin e deklaratës së Sofies lidhur me implementimin e Agjendës së Gjelber.

Një tjetër objektivi i rëndësishëm në këtë strategji është rritja e fleksibilitetit të sistemit të energjisë. Kosova planifikon të krijojë një treg funksional, të integrojë furnizuesit në sistem, të bashkohet me platformat e përbashkëta të balancimit të BE-së (MARI, PICASSO, IGCC), dhe të zbatojë çmime dinamike për konsumatorët tregtarë dhe familjarë.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se Strategjia Kombëtare e Energjisë, ndërsa përpiqet të adresojë sfidat e tranzicionit energjetik, ka disa mangësi të rëndësishme. Për shembull, Strategjia nuk përcakton një afat kohor specifik për mbylljen e termocentraleve me linjit dhe nuk ofron një plan të detajuar për të zëvendësuar kapacitetin e humbur nga këto centrale. Strategjia gjithashtu nuk është e qartë për sa i përket rolit të gazit natyror dhe potencialit për bashkëpunim rajonal me Shqipërinë, veçanërisht për zhvillimin e hidroenergjisë. Për më tepër, ajo nuk ofron garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik.

Prandaj, për të garantuar një të ardhme të qëndrueshme të energjisë, është e domosdoshme që Kosova të rishikojë me kujdes strategjinë e saj energjetike, duke e bërë atë me qëllime më të qarta, më të detajuara dhe më ambicioze.

Një e ardhme energjetike e pasigurt - a do të mjaftojnë planet e dhëna në Strategji?

Kosova është duke përjetuar një rritje të ndjeshme ekonomike dhe ndryshime demografike që do të çojnë në një kërkesë gjithnjë e më të madhe për energji elektrike dhe ngrohje qendrore. Sipas parashikimeve, të dhëna në PNEK 2025-2030 kërkesa për energji elektrike do të rritet për 20.35% midis viteve 2021 dhe 2030, duke arritur në 6,424 GWh, dhe për 45.91% deri në vitin 2040, duke arritur në 8,106 GWh. Kërkesa për ngrohje qendrore pritet të rritet edhe më shumë, për 96.54% deri në vitin 2030, duke arritur në 775 GWh, dhe me 185.5% deri në vitin 2040, duke arritur në 1,401 GWh.

Megjithëse Strategjia e Energjisë e Kosovës 2022-2031 parashikon një plan ambicioz për zgjerimin e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme, si dhe riparimin e kapaciteteve ekzistuese të gjenerimit të energjisë në TC Kosova A dhe TC Kosova B, ekziston një shqetësim në rritje se këto plane mund të mos jenë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën në rritje të vendit.

Strategjia parashikon një rritje të ndjeshme të kapaciteteve të energjisë së rinovueshme, kryesisht energjia diellore dhe e erës, deri në vitin 2031. Megjithatë, pas kësaj date, nuk jep informacion për shtime të mëtejshme të kapaciteteve të gjenerimit dhe ruajtjes së energjisë midis viteve 2031 dhe 2040.

Ndërsa vendi përballet me një rritje të ndjeshme të kërkesës për energji elektrike, planet aktuale të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Klimën dhe Energjinë (PNEK) ngrenë shqetësime serioze për mjaftueshmërinë e tyre në planin afatgjatë. Analiza e të dhënave zbulon një mospërputhje të rrezikshme midis projeksioneve të konsumit të energjisë dhe planeve për zhvillimin e sektorit të energjisë, duke sugjeruar që Kosova mund të përballet me një deficit të energjisë në vitet e ardhshme nëse nuk merren masa të menjëhershme.

Megjithëse Strategjia e Energjisë synon një përzjerje energjie me 35% burime të rinovueshme (BRE) deri në vitin 2031, duke përfshirë një shtim prej 1,600 MW kapacitet të ri të BRE, analiza tregon se këto objektiva janë tepër optimiste dhe nuk marrin parasysh plotësisht realitetin e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme.

Duke marrë parasysh efikasitetin real të energjisë diellore dhe të erës, i cili është zakonisht më i ulët se sa parashikimet zyrtare, prodhimi i përgjithshëm i parashikuar i BRE në vitin 2030 do të jetë dukshëm më i ulët se sa niveli i nevojshëm për të përmbushur kërkesën e pritshme. Kjo mospërputhje thekson nevojën për një vlerësim më realist të potencialit të BRE dhe për planifikim më strategjik për të siguruar që Kosova nuk mbështetet në parashikime të paqëndrueshme.

Për më tepër, analiza e të dhënave të PNEK-ut zbulon një objektiv ambicioz për energjinë e rinovueshme në vitin 2040: 66.3% e përzjerjes së energjisë pritet të vijë nga burime të rinovueshme. Megjithatë, arritja e këtij objektivi, si dhe zëvendësimi i plotë i qymyrit deri në vitin 2050, paraqesin sfida të mëdha.

Kosova do të duhet të ketë një kapacitet të instaluar të BRE prej rreth 2,067 MW, pas vitit 2030 dhe deri në vitin 2040 për të përmbushur objektivin e dhënë në PNEK 2025-2030. Kjo është një rritje e ndjeshme krahasuar me kapacitetin e planifikuar prej 1,600 MW deri në vitin 2031. Megjithatë, arritja e këtij niveli të kapacitetit të BRE, si dhe zëvendësimi i plotë i qymyrit deri në vitin 2050, është jashtëzakonisht vështirë të arrihet për disa arsye:

Së pari, Kosova ka resurse të kufizuara të ujit për hidroenergji, dhe potenciali i saj për energji diellore dhe të erës është i kufizuar nga faktorë gjeografikë. Kjo do të thotë se rritja e kapaciteteve të RES do të jetë e vështirë dhe e kushtueshme.

Së dyti, ritmi i investimeve në BRE është shumë i ngadaltë. Shtimi i 1,600 MW kapacitet BRE deri në vitin 2031 është një qëllim i duhur, por është akoma larg për tu arriturë dhe për të qenë e mjaftueshme për t'i arritur objektivat afatgjata. Mbi këtë, do të nevojiten investime të shumta dhe të vazhdueshme në BRE midis viteve 2031 dhe 2050.

Së treti, zëvendësimi i plotë i qymyrit deri në vitin 2050 do të kërkojë një transformim radikal të sektorit të energjisë së Kosovës. Kjo do të kërkojë jo vetëm investime të mëdha në BRE, por edhe zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për të mbështetur një miksi të ri energjie. Për më tepër, Kosova do të duhet të zëvendësojë plotësisht përdorimin e qymyrit deri në vitin 2050. Kjo do të thotë që pjesa aktuale e prodhimit të energjisë nga qymyri (32.5% në 2040), e cila përbën rreth 3,015 GWh, do të duhet të zëvendësohet me burime të tjera.

Përballë këtyre sfidave, është e qartë se Kosova nuk mund të mbështetet vetëm në energjinë e rinovueshme për të siguruar një të ardhme energjetike të sigurt dhe të qëndrueshme. Qeveria duhet të shqyrtojë me urgjencë alternativa të tjera, siç janë:

- **IMPORTI I GAZIT NATYROR** - Gazi natyror është një burim energjie më i pastër se qymyri dhe mund të luajë një rol të rëndësishëm në tranzicionin e energjisë së Kosovës. Importi i LNG nga Greqia ose lidhja me tubacionin Adriatik në Shqipëri janë opsione që duhen shqyrtuar me seriozitet.
- **INVESTIMET NË BURIMET UJORE TË SHQIPËRISË** - Shqipëria ka një potencial të madh të hidroenergjisë që mund të shfrytëzohet për të prodhuar energji të pastër për të dy vendet. Investimet e përbashkëta në ndërtimin e hidrocentraleve në Shqipëri, të kombinuara me marrëveshje për këmbimin e energjisë, mund të sigurojnë një burim të qëndrueshëm të energjisë për Kosovën.

Duke shqyrtuar këto alternativa, Kosova mund të krijojë një përzierje energjie më të diversifikuar dhe të sigurt, duke i hapur rrugën një të ardhme energjetike më të qëndrueshme. Vonesa në marrjen e vendimeve për këto alternativa mund të çojë në një krizë energjetike në të ardhmen, duke e bërë Kosovën të varur nga importet dhe të ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimeve të energjisë. Prandaj, është e domosdoshme që qeveria të veprojë me shpejtësi dhe vendosmëri për të siguruar një të ardhme energjetike të sigurt dhe të qëndrueshme për Kosovën.



Investimet e përbashkëta në ndërtimin e hidrocentraleve në Shqipëri, të kombinuara me marrëveshje për këmbimin e energjisë, mund të sigurojnë një burim të qëndrueshëm të energjisë për Kosovën.

Rekomandime

Për të shmangur një krizë energjetike në të ardhmen dhe për të siguruar një furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm me energji, është e domosdoshme që qeveria të ndërmarrë masa të guximshme në përmbushjen e obligimeve të marra për implementimin e Agjendës së Gjelbër.

Në vazhdim janë dhënë disa rekomandime konkrete që mund të ndihmojnë në ndryshimin e kursit aktual:

1 Qeveria e Kosovës të rishikojë me urgjencë Strategjinë e Energjisë 2022-2031 dhe të bëjë rregullime të nevojshme për të siguruar që ajo të përputhet me objektivat e Axfordës së Gjelbër. Përparësi duhet të ketë përcaktimi i qartë i një afati kohor për mbylljen e termocentraleve Kosova A dhe Kosova B, duke përfshirë një plan të detajuar për zëvendësimin e energjisë së prodhuar nga këto centrale. Analiza tregon se planet aktuale nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e ardhshme të energjisë.

2 Qeveria e Kosovës duhet të rrisë investimet në energjinë diellore dhe të erës përtej planit aktual të 1,600 MW, duke marrë parasysh efikasitetin e tyre real dhe rritjen e kërkesës për energji elektrike. Analiza tregon se edhe me shtimin e planifikuar të 1,600 MW, Kosova do të përballet me një deficit të energjisë prej 2,524 GWh deri në vitin 2040. Për të përmbushur objektivat e saj për një të ardhme energjetike të qëndrueshme, Kosova duhet të rrisë ndjeshëm kapacitetin e instaluar të BRE, duke përfshirë edhe investime të mëtejshme në teknologjitë e reja për ruajtjen e energjisë.

3 Kosova duhet të shqyrtojë seriozisht mundësinë e importit të gazit natyror nga Greqia sic ishte propozuar nga MCC ose përmes tubacionit Adriatik në Shqipëri. Ky do të ishte një burim energjie më i pastër dhe më i qëndrueshëm se qymyri. Gjithashtu, duhet të shqyrtohet mundësia e riaktivizimit të gazifikimit të linjitet, duke përdorur teknologji moderne të kapjes së karbonit për të minimizuar emetimet.

4 Kosova duhet të zhvillojë një strategji të qëndrueshme për menaxhimin e ujit që merr parasysh kufizimet e këtij resursi vital. Posaqërisht duhet të ndalojë punën e hidrocentraleve të vogla që operojnë në hapësira të mbrojtura – parqe kombëtare. Kjo masë duhet të përfshijë investimin në infrastrukturën e ujit, përmirësimin e efikasitetit të përdorimit të ujit dhe reduktimin e ndotjes së ujit.

5 Qeveria të vazhdojë me investimet në përmirësimin e efikasitetit energjetik, siç është izolimi i ndërtesave, përdorimi i pajisjeve më efikase energjetike, dhe promovimi i transportit publik. Këto nisma duhet të intensifikohen dukshëm se do të ndihmojnë në zvogëlimin e kërkesës për energji dhe do të ulin presionin mbi burimet ekzistuese të energjisë.

6 Është e rëndësishme që qeveria të komunikojë në mënyrë të qartë dhe të hapur me qytetarët për sfidat me të cilat përballet Kosova në sektorin e energjisë dhe për të sqaruar rëndësinë e diversifikimit të burimeve të energjisë. Një dialog i hapur me të gjitha palët e interesuara mund të ndihmojë në krijimin e mbështetjes publike për ndryshimet e nevojshme.

Literatura:

1. Strategjia per Energji e Republikes se Kosoves, 2022-2031
2. Strategjia e energjise se Kosoves, 2019-2027
3. Plani Kombetar per Energji dhe Klime 2025-2030
4. Raporti Vjetor 2023, ZRRE.pdf
5. Raporti vjetor i Statistikave per 2023.pdf
6. Raport vjetor për gjendjen e mjedisit per 2022, AMMK
7. Emetimi e Gazrave Serrë në Kosovë 2014-2019, AMMK
8. Plani Kombetar i Veprimit per Burimet e Ripërteritshme te Energjise (PKVBRE) 2011-2020.pdf
9. Energy Efficiency and Renewable, WB, 2020.pdf
10. Ligji nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike .pdf, janar2024
11. Ligji Nr.08/258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, 2024
12. Ligji Nr.03/L-184 për Energjinë
13. Ligji Nr.3/L-201 për Energjinë Elektrike
14. Ligji Nr.03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë
15. Ligji nr. 06 I-079 për Eficiencë të Energjisë
16. Ligji nr. 05/I 052 – për Energjinë Termike
17. Ligji nr. 05 I-082 për Gazin Natyror
18. <https://reskosovo.rks-gov.net/opportunities/current-projects/wind/solar>



RIINVEST